

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"TacticalFab" Sh.P.K.

Sot në Tiranë, me datë 18/12/2024, Themeluesit e Shoqërisë Tregtare si më poshtë vijon:

- **Z. Sokol EKMEKÇIU** i biri Gazmendit dhe Liljanës, i datëlindjes 12/12/1976, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rr. "Ali Demi" Nd. 165; H. 5; Ap. 67; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake, Tiranë, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. H61212037U, madhor, me zotësi juridike të plotë për të vepruar;
- **Z. Dean FUSHEKATI** i biri i Myrtezait dhe Violetës, i datëlindjes 09/05/1976, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rr. "Luigj Gurakuqi", Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. H60509189A, madhor, me zotësi juridike të plotë për të vepruar;
- **Z. Andi EKMEKÇIU** i biri i Agimit dhe Leonorës, i datëlindjes 01/12/1984, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Rr. "Todi Shkurit", Nd. 13, H. 4, Ap. 33, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. I46201015J, madhor, me zotësi juridike të plotë për të vepruar;

Të cilët së bashku me vullnetin e lirë, vendosën të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (me poshtë Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi si Kushtetuta dhe Kodin Civil, ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar, ligjin Nr. 131, datë 26.11.2015 "*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*", dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1 Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë së vendosur nga Themeluesit është "**TacticalFab**" Sh.P.K.

Neni 2 Selia

1. Selia e Shoqërisë është e vendosur në Tiranë, në adresën: Rr. "Luigj Gurakuqi", Pall. 6, Ap. 17 Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

SE

Neni 4 Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Reublikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) **Projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin** brenda dhe jashtë vendit përfshirë: Të gjitha llojet e armatimeve dhe municioneve; Mjetet e specializuara lëvizëse me ose pa pilot, përfshirë dronët dhe automjetet tokësore, ajrore dhe detare; Pajisjet, instalacionet dhe teknologjitë ushtarake, të specializuara sipas kërkesës së tregut, pa u kufizuar në emërtesa duke përfshirë të gjithë komponentet e tyre përbërës;
- b) Të gjithë aktivitetet ndihmëse dhe të lidhura me këtë veprimtari, do të kryhen në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për përmbushjen e objektit të saj shoqëria do të investojë në kërkimin dhe zhvillimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake, duke përfshirë:

- a) **Projektimin dhe zhvillimin e armëve dhe sistemeve të tyre:** integrimin e teknologjive moderne si inteligjenca artificiale, sensorët inteligjentë dhe teknologjitë autonome.
- b) **Prodhimi dhe zhvillimi i komponentëve:** Investimi në procese industriale të avancuara për prodhimin e pjesëve dhe komponentëve të armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake.
- c) **Pajisje dhe teknologji mbështetëse:** Përfshirja e pajisjeve që rrisin kapacitetet mbrojtëse dhe ofrojnë avantazhe teknologjike në misionet e mbrojtjes kombëtare.

Ky aktivitet ka për qëllim parësor kontributin në rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe teknologjike, në përputhje me interes dhe politikat e sigurisë dhe mbrojtjes strategjike të shtetit dhe partneritetit ndërkombëtar.

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) Lekë. Kapitali Themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 3 (tre) kuota, të gjitha të nënshkruara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin Themeltar të Shoqërisë përcaktuar në neni 10 (dhjetë) të Statutit.

Neni 6 Kontributet

Ortakët e Shoqërisë zotërojnë kuotën e përcaktuar në vlerë nominale dhe përqindje si mëposhtë:

- **z. Sokol Ekmekçiu** i cili zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 90.000 (nëntëdhjetë mijë) Lek, të llojit në kontribut "Para", me pjesëmarrje në përqindje në masën 90 %;

SE

- **z. Dean Fushekati** i cili zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 5.000 (pesë mijë) Lek, të llojit në kontribut "Para", me pjesëmarrje në përqindje në masën 5 %;
- **Z. Andi EKMEKÇIU** i cili zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 5.000 (pesë mijë) Lek, të llojit në kontribut "Para", me pjesëmarrje në përqindje në masën 5 %;

Neni 7

Transferimi i Kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8

Administrimi

Me këtë Akt Themelimi emërohet **1 (një)** Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë vijon:

- **Z. Andi EKMEKÇIU** i biri i Agimit dhe Leonorës, i datëlindjes 01/12/1984, lindur dhe banues në Tiranë, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. 146201015J, madhor, me zotësi të plotë juridike të plotë për të vepruar.

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar, dhe nenit 14 të Statutit.

Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim Administratori mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit sa më lartë cituar.

Neni 9

Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplarin origjinal dhe nënshkruhet nga themeluesit.

THEMELUESIT:

Z. Sokol Ekmekçiu

SOKOL EKMEKÇIU



Z. Dean Fushekati

Dean Fushekati

Z. Andi EKMEKÇIU

Andi Ekmekçiu